REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 26.08.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, bazuar në Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju bëjmë me dije informacionin si më poshtë:

1. *Cili është akti/dokumenti zyrtar që pasqyron vendimmarrjen e AKPT-së për shfuqizimin e instrumentit përkatës të planifikimit, si pasojë, ndryshimin e statusit të objekteve të parashikuara për prishje në këtë zonë? Ju lutemi të bëhet publik akti i plotë, së bashku me hartën dhe dokumentacionin grafik që përcakton qartë objektet dhe territorin e prekur nga ky vendim.*

Akti zyrtar që pasqyron vendimmarrjen për shfuqizimin e aktit nëpërmjet të cilit ishte shpallur Zona e Re për Zhvillim në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, është Vendimi nr. 621, datë 30.7.2026, i Këshillit të Ministrave, "Për shfuqizimin e Vendimit nr. 442, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese'".

Në zbatim të këtij vendimi, aplikimet që do të paraqiten në territorin e ish-Zonës së Re për Zhvillim do të shqyrtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe planifikues në fuqi, konkretisht me Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 4, datë 27.7.2022, të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës".

Vendimi nr. 621, datë 30.7.2026, është i publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), në direktorine "Planet e Detyruara Vendore", butoni "Durrës 5", sipas link-ut: https://planifikimi.gov.al/index.php?id=1024

Gjithashtu, ju informojmë se, bazuar në verifikimin e kryer në platformën e-Harta të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), PDyV Durrës 5, që mbulonte këtë territor nuk rezulton më i publikuar/aktiv në platformë, në përputhje me shfuqizimin e aktit përkatës.

Për sa i përket objekteve të parashikuara për prishje në kuadër të instrumentit të lidhur me ish-Zonën e Re për Zhvillim, statusi i tyre do të vlerësohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe planifikues aktualisht në fuqi, duke pasur në konsideratë shfuqizimin e Vendimit nr. 442, datë 3.6.2020, me Vendimin nr. 621, datë 30.7.2026, të Këshillit të Ministrave, bashkëlidhur si më poshtë:

VENDIM
Nr. 621, datë 30.7.2026

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 442, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" e "iv", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 442, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese".
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

2. *Si do të procedohet me projektin TID Durrës, ndërkohë që projekti është hartuar duke marrë si të mirëqenë prishjen e një numri objektesh, të parashikuara për prishje mbi bazën e aktit tashmë të shfuqizuar, siç është VKM-ja nr. 442, datë 03.06.2020? A do t'i nënshtrohet projekti TID Durrës rishikimit apo riprojektimit, për të reflektuar situatën e re urbanistike dhe juridike të krijuar pas shfuqizimit të këtij akti?*

Qeveria shqiptare me Vendimin nr. 07, datë 02.4.2024 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, ka miratuar lejen e zhvillimit për objektin: "Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në parkun arkeologjik të Durrësit me zhvillues Bashkia Durrës. Miratimi i kësaj lejeje ka ka hapur rrugë për vijimin e procedurave për realizimin e projektit, i cili vlerësohet me rëndësi të veçantë për zhvillimin e trashëgimisë kulturore, turizmit, përmirësimin e hapësirave publike dhe ruajtjen e vlerave të zonave arkeologjike të Durrësit.

Aktualisht, në kuadër të procesit të rishikimit dhe vlerësimit të projektit, po verifikohet gjithashtu nëse brenda zonës së ndërhyrjes ndodhen monumente kulture apo pasuri të tjera kulturore që gëzojnë status mbrojtjeje. Për këtë qëllim, është ngritur një grup ndërinstitucional, nga i cili pritet informacioni dhe vlerësimi përkatës lidhur me monumentet historike, pasuritë kulturore dhe elementët e trashëgimisë kulturore që mund të ndodhen brenda zonës së ndërhyrjes.

Gjithashtu, në kuadër të këtij procesi janë zhvilluar takime në nivel institucional, përfshirë takime me Kryeministrin, si dhe janë marrë në konsideratë kërkesat dhe shqetësimet e shprehura nga qytetarët, me qëllim që këto elemente të reflektohen në vlerësimin e mëtejshëm të projektit. Për çdo rast të evidentuar, ndërhyrjet do të trajtohen në përputhje me situatën aktuale urbanistike, juridike dhe faktike të zonës, legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe në koordinim me institucionet përgjegjëse.

Në këtë kuadër, projekti synon të krijojë kushte për rigjallërimin e zonës, rritjen e atraktivitetit të saj për qytetarët, vizitorët dhe bizneset, si dhe forcimin e rolit të Durrësit si një destinacion i rëndësishëm kulturor dhe turistik.

Pas shfuqizimit të Planit të Detyruar Vendor, Bashkia Durrës po vlerëson mundësinë për vijimin e procedurave për hartimin dhe miratimin e një Plani të Detajuar Vendor (Plan Pikësor), në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, VKM nr. 408/2015, Ligjin nr. 139/2015, VKM-në nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore" i ndryshuar si dhe VKM-në nr.686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", me qëllim zhvillimin e rregullt të territorit, respektimin e të drejtave të pronësisë dhe realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.